

RREGULLORE

(Mbi mënyrën e organizimit të lojës promovionale)

Me qëllim që të përcaktohen rregullat dhe mënyra e organizimit të lojës promovionale për klientët individë, të cilët do të përdorin kartat e debitit, kreditit dhe Portofolin Digjital RaiPay gjatë periudhës 15 Nëntor 2024 – 31 Dhjetor 2024, në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr.196, datë 15.3.2017 "Për përcaktimin e mënyrave, formave, kritereve dhe rregullave për organizimin e lojërave të fatit promovionale", Departamenti i Marketingut dhe Departamenti i Bankingut Ditor & Biznesi me Kartat, nxjerrin këtë Rregullore:

1. Lloji i lojës promovionale

- 1.1 Duke filluar nga data **15 Nëntor 2024 deri me 31 Dhjetor 2024**, Raiffesen Bank Sh.a do të organizojë një lojë promovionale për të gjithë klientët individë (ekzistues dhe të rinj), që do të përdorin kartat e debitit, kreditit dhe portofolin digjital RaiPay, për pagesa në pika shitje POS, si dhe për blerje online, brenda vendit. Kjo lojë zhvillohet me qëllim promovimin e produkteve dhe shërbimeve të Raiffeisen Bank sh.a.
- 1.2 Në lojën promovionale do të konsiderohen të vlefshme të gjitha veprimet e kryera me kartat e debitit, kreditit dhe portofolin digjital RaiPay, në pikat e Shitjes (POS), si dhe për pagesat online, vetëm brenda vendit, të autorizuara si të suksesshme gjatë periudhës së lojës promovionale. Mbas përfundimit të periudhës promovionale do të hidhet një shorte për të përzgjedhur 50 (pesëdhjetë) klientë fitues.

2. Kohëzgjatja e lojës

- 2.1 Kalendarri promovional fillon me datë 15 Nëntor 2024 dhe mbaron me date 31 Dhjetor 2024. Në rast se autorizimi nga AMLF, do të jepet mbas datës 15 Nëntor 2024, kalendarri promovional do të fillojë nga data e dhënies së autorizimit.
- 2.2 Shorteu për çmimin fitues do të hidhet më datë 15 Janar 2024. Njoftimi për datën dhe orën e ndarjes së çmimeve, do të depozitohet pranë AMLF dhe organit tatimor, 20 (njëzet) ditë përpara datës së zhvillimit të shorteut.

3. Numri i çmimeve dhe mënyra e shpërblimit të fituesve

- 3.1 Mbas përfundimit të periudhës së promovionit, do të jepen 50 (pesëdhjetë) çmime për 50 (pesëdhjetë) fitues.

3.2 Çmimet që do të jepen janë :



- 10 (dhjetë) kufje
- 10 (dhjetë) Smartphone
- 20 (njëzetë) ora Smart
 - 10 (dhjetë) Apple Smartwatches
 - 10 (dhjetë) Samsung Smartwatches
- 8 (tetë) laptopë
- 2 (dy) kuti me një kombinim dhuratash, ku secila kuti do të përmbajë:
 - 1 (një) Smartphone
 - 1 (një) orë Smart
 - 1 (një) kufje

3.3 Kartëmbajtësi që shpallet fitues i një prej çmimeve nuk ka të drejtë ta transferojë çmimin tek persona të tretë.

4. Kosto për pjesëmarrësit

4.1 Klientët individë që do të jenë pjesë e kësaj loje promovionale nuk kanë kosto shtesë për pjesëmarrjen në këtë promovion. Ata janë të ftuar të përdorin kartat e debitit, kreditit dhe Portofolin Digjital RaiPay, sipas kushteve të përcaktuara për të qenë pjesë e shorteut.

5. Vlera monetare e çmimeve të ofruara / Tatimi në burim

5.1 Tabela e cmimeve fituese

		Cmimi/copë	Vlera Totale	Total
Emertimi i cmimit fituese	Sasia/Copë	PA TVSH/Lekë	PA TVSH/Lekë	Lekë me TVSH
Kufje "Apple AirPods Max"	10	62,492	624,917	749,900
Smartphone SAMSUNG GALAXY S24 Ultra	10	124,992	1,249,917	1,499,900
Apple Smartwatches	10	49,158	491,583	589,900
Samsung Smartwatches	10	24,992	249,917	299,900
Laptop "Apple Macbook"	8	129,158	1,033,267	1,239,920
Smartphone SAMSUNG GALAXY ZFOLD6	2	174,992	349,983	419,980
Kufje SAMSUNG Galaxy Buds 2 Pro Gray	2	21,658	43,317	51,980
SAMSUNG Galaxy Watch7.	2	41,658	83,317	99,980
				4,951,460

* Çmimet e produkteve në momentin e blerjes së tyre, mund të jenë të ndryshme nga çmimet e përcaktuara si më sipër.

5.2 Për të ardhurat që do të realizojnë fituesit e lojës promovionale, Raiffeisen Bank sh.a. do të mbajë tatimin në burim dhe do ta derdhë atë në llogarinë e organit tatimor, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse.

6. Numri i parashikuar i pjesëmarrësve në lojë

6.1 Numri i parashikuar i pjesëmarrësve në lojë do të jetë rreth 22,000 klientë.

6.2 Probabiliteti: 0.22%/ klient

7. Pjesëmarrësit që kanë të drejtë të marrin pjesë në lojë / Kufizimet



- 7.1 Konsiderohen të kualifikuar për të marrë pjesë në lojën promovionale të gjithë klientët e Raiffeisen Bank Sh.a. (ekzistues dhe te rinj) që kanë një kartë debiti, krediti dhe / ose Portofolin digjital RaiPay dhe që do të plotësojnë kushtet si më poshtë:
- ***Të kenë kryer minimumi 5 (pesë) transaksione të suksesshme/ të vlefshme në pika shitje POS, apo pagesa online, vetëm brenda vendit, gjatë periudhës së fushatës (15 Nëntor - 31 Dhjetor 2024). Nuk ka vlerë minimale për pjesëmarrjen në lojën promovionale.***
- 7.2. Numri i transaksioneve që mund të kryejë çdo kartëmbajtës për t'u bërë pjesë e lojës është i pakufizuar, mjafton që të përmbushet kriteri i numrit minimal të transaksioneve.
- 7.3. Nëse klienti ka kartë shtesë në llogari në emër të një klienti tjetër, transaksionet e kryera me këtë kartë do të llogariten si transaksione të kryera nga kartëmbajtësi i kartës shtesë.
- 7.4. Nuk do të llogariten transaksionet e kryera me karta që janë të lidhura me llogari biznesi të klientit.
- 7.5. Nuk konsiderohen transaksione të vlefshme me kartë për lojën promovionale, ato veprime që rezultojnë të pasuksesshme ose për të cilat është kryer veprimi i kthimit mbrapsht të vlerës (refund).
- 7.6. Staf i Raiffeisen Bank Sh.a, Raiffeisen Invest Sh.a dhe Raiffeisen Leasing Sh.a. nuk do të përfshihen në këtë shorte. Këtij rregulli i nënshtrohen edhe kartat shtesë për këtë kategori.

8. Mënyra e përzgjedhjes së fituesve dhe vendi ku do të bëhet përzgjedhja

- 8.1 Pas përfundimit të periudhës së promovionit do të gjenerohet një listë me të gjithë klientët individë që kanë përdorur kartat e debitit, kreditit dhe Portofolin Digjital RaiPay dhe që kanë plotësuar kushtet për të qenë pjesë e shorteut. Informacioni për të gjithë klientët do të përpunohet nga data 7 Janar 2025 – 12 Janar 2025.
- 8.2 Shorteu do të zhvillohet me datë 15 Janar 2025, në zyrat qendrore të Raiffeisen Bank sh.a. në adresën: Rruga "Tish Daija", Kompleksi KIKA 2, Tirane.
- 8.3 Përzgjedhja e fituesve do të bëhet nëpërmjet një programi kompjuterik dhe çmimet do të ndahen si më poshtë:
- 10 klientët e parë fitues, përfitojnë nga 1 (një) orë Samsung
 - 10 klientët e dytë fitues, përfitojnë nga 1 (një) orë Apple
 - 10 klientët e tretë fitues, përfitojnë nga 1 (një) palë kufje Apple
 - 10 klientët e katërt fitues, përfitojnë nga 1 (një) Smartphone Samsung
 - 8 klientët e pestë fitues, përfitojnë nga 1 (një) Laptop Apple
 - 2 klientët e rradhës, përfitojnë nga 1 (një) kuti me kombinimin e dhuratave (Smartphone Samsung ZFOLD + orë Samsung+ kufje Samsung)
- 8.4 Mbas shpalljes së fituesve, organizatori i lojës do të përzgjedhë edhe 110 (njëqind e dhjetë) emra të tjerë (rezervë) në prani të komisionit, të cilëve do t'u akordohet çmimi në rast se ndonjë prej fituesve:
- a. refuzon të marrë çmimin e ofruar nga Banka;
 - b. nuk ka një mjet të vlefshëm identifikimi;
- 8.5 Fituesit rezervë do të përzgjidhen për secilën kategori të çmimeve, të ndarë si më poshtë:
- 20 fitues rezervë për orë Samsung
 - 20 fitues rezervë për orë Apple
 - 20 fitues rezervë për kufje Apple
 - 20 fitues rezervë për Smartphone Samsung



- 20 fitues rezervë për Laptop Apple
- 10 fitues rezervë, për 2 kutitë me kombinimin e cmimeve

9. Mënyra e njoftimit të fituesve

- 9.1 Fituesit do të njoftohen me telefon ose e-mail nga ana e Bankës, duke ju referuar numrit të telefonit dhe adresës elektronike që kanë të regjistruar në sistemet e Raiffeisen Bank. Njoftimi i fituesve nëpërmjet telefonatës dhe me e-mail do të bëhet nga ana e Contact Center (Njësia e Kontaktit me Klientin).
- 9.2 Çdo klient fitues duhet të konfirmojë pranimin e çmimit brenda 24 orësh nga telefonata ose marrja e e-mailit në adresën elektronike, nëpërmjet telefonatës ose e-mailit. Nëse kartëmbajtësi fitues nuk konfirmon pranimin e çmimit brenda afatit të mësipërm, e humb të drejtën e përfitimit të çmimit fitues. Në këto kushte, Bankës i lind e drejta ta transferojë çmimin tek klienti i radhës, nga lista e fituesve rezervë të përzgjedhur sipas pikës 8.4.
- 9.3 Fituesit e radhës do të njoftohen në të njëjtën mënyrë, me telefon ose e-mail nga ana e Bankës. Kartëmbajtësi duhet të konfirmojë pranimin e çmimit brenda 24 orësh nga telefonata, ose dërgimi i njoftimit në adresën elektronike.
- 9.4 Klienti fitues që ka konfirmuar pranimin e çmimit, duhet të paraqitet pranë zyrave qendrore të Raiffeisen Bank sh.a. në adresën: Rruga "Tish Daija", Kompleksi KIKA 2, Tiranë brenda datës 31 Janar 2025 për të tërhequr çmimet.

10. Mekanizmi i lojës promovionale

- 10.1 Fituesi i lojës promovionale do të përcaktohet me një përzgjedhje të rastësishme, nëpërmjet një programi kompjuterik.
- 10.2 Elementi që përcakton fituesit është Emri, Mbiemri, NRP, Qyteti/Rrethi dhe numri i kartës (i maskuar).
- 10.3 Programi software me anë të të cilit do të bëhet përzgjedhja e fituesve është ndërtuar nga Divizioni i TI-së pranë Raiffeisen Bank. Në këtë proces është siguruar që të mos ketë ndërhyrje njerëzore, por të gjitha të dhënat të gjenerohen automatikisht nga sistemi i bankingut digjital. File me të dhënat e klientëve ngarkohet në sistemin e ndërtuar, i cili zgjedh në mënyrë rastësore një emër nga lista.

11. Hyrja në fuqi

- 11.1 Kjo Rregullore është hartuar në përputhje me rregullat e përcaktuara në VKM nr.196, datë 15.3.2017 "Për përcaktimin e mënyrave, formave, kritereve dhe rregullave për organizimin e lojërave të fatit promovionale".
- 11.2 Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe është e vlefshme deri në përfundim të kësaj loje promovionale.